

L I G J
Nr.7893, datë 22.12.1994

PËR SHKENCËN DHE ZHVILLIMIN TEKNOLOGJIK

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I

Neni 1

Fusha e veprimtarisë

Ky ligj përcakton bazat dhe parimet e organizimit, të drejtimit, të kryerjes dhe të vlerësimit të veprimtarisë shkencore dhe zhvillimit teknologjik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Përkufizime

Në kuptimin e këtij ligji:

- Veprimtari shkencore dhe të zhvillimit teknologjik (veprimtari shkencore dhe teknologjike) quhen të gjitha veprimtaritë sistematike, që kryhen për të përfituar, rritur, përhapur dhe përdorur njohuritë shkencore dhe teknologjike në të gjitha fushat e shkencës dhe të teknologjisë. Këto veprimtari përfshijnë kërkimin shkencor dhe zhvillimin teknologjik (shkurt kërkimin dhe zhvillimin), formimin dhe përgatitjen shkencore e teknike, shërbimet shkencore e teknologjike.

- Kërkim shkencor (kërkim) quhen të gjitha veprimtaritë sistematike e krijuese, që kryhen për të rritur vëllimin e njohurive shkencore dhe zbatimet e tyre, si në studimin e natyrës, të teknikës e të prodhimit, ashtu edhe në studimin e njeriut, të kulturës e të shoqërisë.

- Kërkim fundamental (kërkim bazë) quhen të gjitha veprimtaritë origjinale teorike dhe eksperimentale për të përftuar njohuri të reja mbi fenomenet dhe faktet e vrojtues, për të cilat nuk parashikohet ndonjë zbatim a përdorim specifik.

- Kërkim i aplikuar quhen të gjitha veprimtaritë krijuese origjinale për të përftuar njohuri të reja që synojnë kryesisht një objektiv ose zbatim praktik.

- Zhvillim teknologjik (zhvillim) quhen të gjitha veprimtaritë sistematike, që kryhen për të transferuar teknologjinë, për të prodhuar materiale, produkte e pajisje të reja, për të futur procedura të reja prodhimi e organizimi ose për të përmirësuar thellësisht ato ekzistuese, duke shfrytëzuar njohuritë e fituara nga kërkimi shkencor dhe përvoja praktike.

- Formim dhe përgatitje shkencore e teknike quhen veprimtaritë e shkollimit të lartë (universitar ose jouniversitar), të kualifikimit e të specializimit të vazhdueshëm dhe të përgatitjes sistematike të shkencëtarëve dhe të specialistëve për kërkim e zhvillim.

- Shërbime shkencore dhe teknologjike quhen të gjitha veprimtaritë sistematike të lidhura me kërkimin dhe zhvillimin, që ndihmojnë në përfitimin, përhapjen dhe përdorimin e dijeve shkencore dhe teknologjike (informacioni shkencor e teknik; shërbimi i bibliotekave shkencore e teknike; veprimtaritë e muzeve natyrore e teknike; vrojtimet gjologjike, hidrologjike, meteorologjike, sizmologjike, pedologjike, radioaktive, epidemiologjike e epizootike; shërbimet metrologjike e kalibruese; kontrolli i cilësisë; grmbullimi i të dhënave për dukuritë shoqërore, ekonomike, demografike, veprimtaria për patentat dhe licencat; këshillimet shkencore e teknologjike).

- Financim institucional është financimi i orientuar për mbajtjen dhe funksionimin e institucionit si një njësi e tërë.

- Financim problemor është financimi i orientuar për realizimin e programeve dhe projekteve të lidhura me probleme të caktuara.

Neni 3 **Përparësia**

Veprimtaritë shkencore dhe teknologjike janë përparësi kombëtare.

Neni 4 **Mbështetja shtetërore e veprimtarisë shkencore dhe teknologjike**

1. Shteti krijon kushtet ligjore dhe organizative për veprimtarinë shkencore e teknologjike dhe mbështet veprimtarinë e institucioneve shtetërore përkatëse e të personelit të tyre.
2. Shteti inkurajon zhvillimin e veprimtarisë shkencore e teknologjike edhe jashtë institucioneve shtetërore nga subjekte (organizma e persona) private shqiptare e të huaja.

Neni 5 **Liria dhe larmia e kërkimit dhe e zhvillimit**

1. Liria e kërkimit shkencor dhe e zhvillimit teknologjik është e garantuar me ligj. Ajo përfshin:
 - zgjedhjen e problematikës shkencore;
 - parimet bazë metodike;
 - vlerësimin e rezultateve kërkimore;
 - përhapjen e këtyre rezultateve.Mbështetja shtetërore synon të vendosë një raport të drejtë ndërmjet lirisë së kërkimit shkencor dhe domosdoshmërisë së përfitimit sa më të madh nga financimi i dhënë.
2. Organet shtetërore, universitetet e shkollat e larta dhe Akademia e Shkencave sigurojnë larinë e shkencave, si dhe zhvillimin shkencor të punonjësve të institucioneve të tyre.

Neni 6 **Qëllimet dhe objektivat e veprimtarisë shkencore dhe teknologjike**

1. Veprimtaria shkencore dhe teknologjike ka për qëllim themelor:
 - përfitimin, rritjen dhe transmetimin e dijeve shkencore dhe teknologjike në të gjitha fushat, në veçanti për pasuritë natyrore të vendit dhe pasuritë shpirtërore, historike e kulturore të popullit;
 - shfrytëzimin dhe përdorimin e tyre racional për përparimin harmonik e demokratik të shoqërisë, të ekonomisë e të kulturës.
2. Objektivat e veprimtarisë shkencore dhe teknologjike caktohen në përputhje me qëllimet e mësipërme dhe me objektivat e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.
3. Veprimtaria shkencore dhe teknologjike udhëhiqet nga:
 - e vërteta shkencore;
 - mbrojtja dhe zhvillimi i interesave kombëtare;
 - liria e veprimtarisë shkencore dhe e mësimi të saj;
 - domosdoshmëria e ndërthurjes së kërkimit me arsimin e lartë;
 - respektimi i të drejtave të pronësisë intelektuale;
 - përgjegjësia morale e shkencëtarëve për pasojat e veprës së tyre;
 - kooperimi shkencor e teknologjik ndërkombëtar.
4. Rezultatet e veprimtarisë shkencore e teknologjike të institucioneve vihen në dispozicion të shoqërisë. Ndërkaq pronësia mbi to rregullohet sipas ligjit për pronësinë industriale dhe të dispozitave ligjore të tjera.

Neni 7 **Politika shkencore dhe teknologjike**

1. Politika shtetërore në fushën e veprimtarisë për kërkim shkencor dhe zhvillim teknologjik (këtej e tutje politika shkencore dhe teknologjike), është pjesë përbërëse e politikës tërësore të zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit dhe shpreh qëndrimin e shtetit ndaj kësaj veprimtarie.

2. Politika shkencore dhe teknologjike ka për qëllim:

- të përcaktojë objektivat, drejtimit dhe përparësitë e veprimtarisë shkencore e të zhvillimit teknologjik, duke i harmonizuar ato me zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendit dhe të rajoneve të veçanta të tij;

- të përcaktojë mekanizmat ligjorë, administrativë, financiarë dhe institucionalë në fushën e shkencës e të teknologjisë për të arritur përdorimin sa më efikas të potencialeve shkencore e teknologjike të vendit;

- të përcaktojë drejtimit dhe objektivat e përmirësimit të vazhdueshëm të strukturës së rrjetit të institucioneve shkencore dhe të fuqizimit të universiteteve si qendra të veprimtarisë shkencore dhe të zhvillimit teknologjik;

- të forcojë lidhjet funksionale dhe operationale të veprimtarisë shkencore e të zhvillimit teknologjik me kërkesat e ekonomisë së tregut;

- të përcaktojë shpenzimet publike për veprimtarinë shkencore e teknologjike;

- të stimulojë integrimin e veprimtarisë kombëtare të kërkimit e të zhvillimit në veprimtarinë shkencore dhe teknologjike botërore;

- të nxitë veprimtarinë shkencore e teknologjike në nivel rajonal;

- të nxitë procesin e privatizimit në veprimtarinë shkencore dhe të zhvillimit teknologjik;

- të përcaktojë objektiva për përgatitjen dhe kualifikimin e personelit të nevojshëm për kërkim e zhvillim dhe formimin e personelit drejtues të tyre.

Neni 8

Miratimi i politikës shkencore dhe teknologjike

Politika shkencore dhe teknologjike përgatitet nga Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave, ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, me pjesëmarrjen e institucioneve shkencore dhe të shkollave të larta dhe paraqitet në Këshillin e Politikës Shkencore dhe të Zhvillimit Teknologjik, i cili bashkë me mendimin e tij ia kalon Këshillit të Ministrave për ta përfshirë në programet e qeverisë për zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendit.

Neni 9

Programet kombëtare të kërkimit dhe të zhvillimit

Për të realizuar objektivat e politikës shkencore dhe teknologjike hartohen programe kombëtare të kërkimit dhe të zhvillimit.

Programet kombëtare të kërkimit dhe të zhvillimit përcaktojnë:

- objektivat e kërkimit dhe të zhvillimit në fushën përkatëse;

- institucionet dhe ekipet shkencore përgjegjëse dhe bashkëpunëtore, duke përfshirë, eventualisht, edhe ato të huaja;

- përmirësimet infrastrukturore për arritjen e objektivave të caktuara;

- fondet buxhetore dhe, eventualisht, ekstrasubvetore;

- rezultatet e pritshme dhe afatet përkatëse.

Neni 10

Miratimi i programeve kombëtare të kërkimit dhe të zhvillimit

Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë, në bazë të objektivave të politikës shkencore e teknologjike të miratuar, shpall fushat përparësore, për të cilat do të hartohen programe kombëtare të kërkimit dhe të zhvillimit. Propozime për hartimin e këtyre programeve paraqesin shkollat e larta, Akademia e Shkencave, ministrinë me institucionet kërkimore-shkencore të tyre e të tjerë.

Propozimet e paraqitura shqyrtohen dhe vlerësohen duke përdorur ekspertizën e pavarur.

Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë përgatit dhe i paraqet për miratim Këshillit të Politikës

Shkencore dhe të Zhvillimit Teknologjik programet kombëtare të kërkimit e të zhvillimit.

Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë nxjerr udhëzime për procedurat e përgatitjes, të paraqitjes, të vlerësimit dhe të miratimit të programeve kombëtare të zhvillimit dhe të kërkimit.

Neni 11

Projektet e kërkimit dhe të zhvillimit

Për të zbatuar programet kombëtare të kërkimit dhe të zhvillimit hartohen projekte të kërkimit dhe të zhvillimit.

Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë lëshon udhëzime për mënyrën e hartimit, të vlerësimit dhe të miratimit të projekteve të kërkimit e të zhvillimit.

KREU II

INSTITUCIONE SHKENCORE

Neni 12

Përcaktimi i institucioneve shkencore

Institucione shkencore shtetërore janë:

1. Universitetet, shkollat e larta dhe institutet kërkimore në përbërje të tyre.
2. Institutet dhe qendrat shkencore të Akademisë së Shkencave.
3. Institutet dhe qendrat shkencore të ministrive, të Komitetit të Shkencës e të Teknologjisë dhe të institucioneve qendrore.
4. Qendrat kombëtare të kërkimeve.

Neni 13

Statuti juridik

1. Ngritja, shkrija, bashkimi ose ndarja e institucioneve shkencore shtetërore që përcaktohen në nenin 12 (pika 2,3 e 4) bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, në bazë të propozimit të ministrive e të institucioneve qendrore, pasi të jetë marrë mendimi i Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë, i Ministrisë së Financave dhe i Këshillit të Politikës Shkencore e të Zhvillimit Teknologjik.

Për institucionet që përcaktohen në nenin 12, pika 1, veprohet në bazë të ligjit për arsimin e lartë.

2. Institucionet që përcaktohen në nenin 12 janë persona juridikë.

3. Universitetet e shkollat e larta dhe Akademia e Shkencave gëzojnë të drejtën e autonomisë në kuadrin e këtij ligji, si dhe të ligjit për arsimin e lartë dhe të statutit të Akademisë së Shkencave përkatësisht.

Neni 14

Detyrat e institucioneve shkencore

Institucionet e përcaktuara në nenin 12 i shërbejnë në mënyrë të vazhdueshme zhvillimit të shkencës e të teknologjisë në fushat përkatëse, transferimit të teknologjisë, kualifikimit të pandërprerë të personelit të tyre dhe formimit të shkencëtarëve të rinj. Ato duhet të zgjidhin edhe detyra të veçanta që i dalin vendit.

Neni 15

Programimi dhe raportimi

1. Institucionet e përcaktuara në nenin 12 hartojnë plane zhvillimi që përmbajnë detyrat dhe ecurinë perspektive në tërësi dhe të njësive përbërëse të tyre, në veçanti synimet dhe objektivat kërkimorë e zhvillimorë, angazhimin dhe kërkesat për personelin dhe vendet e punës, shfrytëzimin dhe nevojat për mjetet shkencore dhe mjediset e punës.

2. Mbi bazën e planeve të zhvillimit hartohen plane pune njëvjeçare për zhvillimin e veprimtarisë së institucionit.

3. Për veprimtarinë e kryer institucionet raportojnë në ministri ose në institucionin qendror përkatës në fund të vitit kalendarik.

Neni 16 **Mbikëqyrja**

1. Institucionet e përcaktuara në nenin 12 i nënshtrohen mbikëqyrjes nga shteti, veçanërisht për çështjet e buxhetit dhe ato ekonomike (përdorimi i mjeteve shtetërore buxhetore, vendet e personelit, administrimi i pasurive, llogaria e financat, investimet). Për çështjet, të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me kërkimin shkencor e zhvillimin teknologjik, mbikëqyrja e shtetit kufizohet vetëm në aspektet juridike (respektimin e akteve ligjore e nënligjore dhe të marrëveshjeve e kontratave përkatëse).

2. Mbikëqyrja e shtetit ushtrohet nëpërmjet ministrive ose institucionit qendror përkatës. Këshilli i Ministrave vendos rregulla për këtë qëllim.

Neni 17 **Universitetet dhe shkollat e larta**

Universitetet dhe shkollat e larta, si dhe njësitë shkencore në përbërje të tyre, organizohen, drejtohen dhe funksionojnë si institucione shkencore në bazë të ligjit për arsimin e lartë dhe të neneve të tjera të këtij ligji.

Neni 18 **Akademia e Shkencave**

1. Akademia e Shkencave të Shqipërisë (më tej Akademia), është institucion qendror shkencor kombëtar, që përfshin në sistemin e vet institucione shkencore dhe Asamblenë.

2. Akademia është person juridik në varësi të Këshillit të Ministrave.

3. Akademia ka për detyrë:

- të kryejë kërkime shkencore fundamentale dhe aplikative në fusha të ndryshme të shkencave sociale, humanitare, natyrore e albanologjike;

- të kujdeset për të hapur fusha të reja të kërkimeve shkencore, në përputhje me nevojat e vendit;

- t'u parashtrojë organeve shtetërore çështje të rëndësishme për gjendjen e kërkimit shkencor e të zhvillimit teknologjik në fusha të ndryshme për rrugët e zhvillimit të shkencës e të kulturës;

- të punojë për përfshirjen sa më të frytshme të shkencës shqiptare në shkencën botërore.

4. Asambleja e Akademisë përbëhet nga anëtarë dhe anëtarë-korrespondentë të Akademisë, që zgjidhen ndër shkencëtarët më të shquar dhe përfaqësues më në zë të kulturës së vendit. Numri i anëtarëve dhe i anëtarëve korrespondentë të Akademisë miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Akademia ka edhe anëtarë nderi.

5. Për drejtimin e veprimtarisë së institucioneve shkencore të Akademisë krijohet Këshilli Drejtues i Akademisë, i cili përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetarët, sekretari shkencor dhe drejtorët e institucioneve shkencore të Akademisë.

6. Akademia ka statutin e vet, i cili miratohet nga Këshilli i Ministrave. Statuti përmban rregullat e zgjedhjes së anëtarëve të Asamblesë, organizimin, drejtimin e funksionimit të institucioneve shkencore e të organizmave të tjera etj.

Neni 19 **Institucionet shkencore të ministrive dhe të institucioneve qendrore**

1. Institucionet shkencore të sistemit të ministrive dhe të institucioneve qendrore kryejnë veprimtari kërkimore, zhvillimore dhe projektuese, kryesisht aplikative, në fushat përkatëse për njohjen dhe përdorimin e pasurive natyrore, për zhvillimin e transferimin e teknologjive, për futjen e

prodhimeve të reja etj. Drejtimet themelore të veprimtarisë së institucionit përcaktohen në vendimin për krijimin e tij.

2. Në strukturën organizative të këtyre institucioneve mund të ketë departamente, sektorë, njësi kërkimore, zhvillimore e projektuese, njësi shërbimi shkencor e teknologjik për transferimin e teknologjisë dhe futjen e prodhimeve të reja, sektorë marketingu sipas natyrës dhe specifikës së tij. Struktura organizative e institucionit propozohet nga Këshilli Drejtues i tij dhe miratohet nga ministri përkatës.

Neni 20

Organet drejtuese të institucioneve shkencore të ministrive dhe të institucioneve qendrore

1. Organet drejtuese të institucioneve shkencore të përcaktuara në nenin 12 (pika 2,3 e 4), janë Këshilli Drejtues dhe drejtori.

2. Këshilli Drejtues përbëhet nga drejtori i institucionit shkencor, punonjës shkencorë e administrativë të institucionit dhe, si rregull, edhe përfaqësues të njësive, që kryejnë veprimtari ekonomike që lidhen me institucionin.

Numri dhe përbërja e Këshillit Drejtues miratohet nga ministri ose titullari i institucionit qendror përkatës mbi bazën e propozimit të institucionit.

Kryetar i Këshillit Drejtues është drejtori i institucionit.

3.a) Këshilli Drejtues shqyrton dhe miraton:

- planin e zhvillimit të institucionit;
- problemet e financimit dhe të planit financiar të institucionit;
- problemet e vendeve të punës dhe çështjet sociale që lidhen me kushtet e punës;
- raportimet e drejtorit për ecurinë e planit të zhvillimit dhe realizimin e planit financiar të institucionit.

b) Këshilli Drejtues shqyrton dhe jep mendime për:

- strukturën organizative të institucionit;
- rregulloren e institucionit.

4. Drejtori

- organizon, drejton dhe përgjigjet për punën e institucionit;
- përfaqëson institucionin në të gjitha marrëdhëniet juridike;
- thërret dhe drejton mbledhjet e Këshillit Drejtues e të Këshillit Shkencor dhe zbaton vendimet e tyre;
- bën emërimin e punonjësve në bazë të rezultateve të konkursit;
- jep urdhra e udhëzime dhe vendos sanksione në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- raporton përpara Këshillit Drejtues për ecurinë e planit të zhvillimit dhe për realizimin e planit financiar të institucionit;
- raporton përpara Këshillit Shkencor për realizimin e planeve të punës për kryerjen e veprimtarisë kërkimore e zhvillimore të institucionit;
- raporton përpara ministrisë ose institucionit qendror përkatës në fund të vitit kalendarik.

5. Drejtori emërohet nga ministri ose titullari i institucionit qendror përkatës me propozimin e Këshillit Drejtues të jo më pak se dy kandidatëve, për një afat trevjeçar të përsëritshëm vetëm njëherë.

Neni 21

Këshilli shkencor

1. Në çdo institucion shkencor, që përcaktohet në nenin 12 (pika 2,3 e 4) ngrihet dhe funksionon Këshilli Shkencor.

a) Këshilli Shkencor shqyrton dhe miraton:

- projektet e kërkimit dhe të zhvillimit të institucionit dhe ato ku institucioni është bashkëpunëtor;
- studimet e kryera në përfundim e zbatim të projekteve;
- marrëveshjet e bashkëpunimit shkencor e teknologjik me institucione të tjera të vendit e të huaja;
- raportin e drejtorit për realizimin e planeve të punës për kryerjen e veprimtarisë kërkimore

dhe zhvillimore të institucionit.

b) Këshilli Shkencor shqyrton dhe jep mendim:

- për programet kombëtare në të cilat përfshihet institucioni, duke ia përcjellë ministritë ose institucionit qendror përkatës;

- për probleme të kualifikimit dhe të specializimit shkencor, që përfshihen në planin e zhvillimit të institucionit;

- për analizën dhe vlerësimin e veprimtarisë kërkimore dhe zhvillimore të institucionit të kryer nga vetë institucioni ose nga organizma jashtë tij;

- për probleme të tjera, në veçanti për probleme që lidhen me studime e investime në fusha që mbulon institucioni, kur këtë e kërkon ministri a titullari i institucionit qendror përkatës, ose Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë, ose Këshilli i Politikës Shkencore dhe të Zhvillimit Teknologjik.

2. Këshilli Shkencor përbëhet nga anëtarë të brendshëm dhe të jashtëm. Anëtarët e brendshëm zgjidhen me votim të fshehtë nga punonjësit shkencorë të institucionit. Anëtarët e jashtëm, që përbëjnë jo më shumë se një të tretën, propozohen nga drejtori i institucionit.

Emërimet e anëtarëve të Këshillit Shkencor bëhen nga ministri ose titullari i institucionit qendror përkatës për një afat trevjeçar të përsëritshëm.

3. Drejtori i institucionit është kryetar i Këshillit Shkencor.

Neni 22

Rregullorja

Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore miratojnë rregulloret e organizimit dhe të funksionimit të institucioneve të sistemit të tyre, në bazë të këtij ligji dhe udhëzimeve të Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë, me përjashtim të institucioneve të përcaktuara në nenin 12, pika 1, për të cilat veprohet në bazë të ligjit “Për arsimin e lartë”.

Neni 23

Qendra Kombëtare të kërkimit shkencor

Qendra kombëtare të kërkimit shkencor ngrihen sipas procedurës së caktuar në nenin 13, pika 1. Statuti i qendrave të tilla miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 24

Veprimtaria fitimprurëse e institucioneve shkencore

Institucionet shkencore të përcaktuara në nenin 12 kanë të drejtë që brenda kuadrit të detyrave themelore e të specialiteteve të tyre të zhvillojnë veprimtari shkencore e teknologjike (studime, projekte, ekspertiza, kurse etj.) për të tretë (firma e persona juridikë e fizikë shtetërorë e privatë të vendit e të huaj), për të siguruar burime financimi që administrohen në bazë të dispozitave në fuqi.

Neni 25

Institucione të përbashkëta dhe ndërkombëtare

1. Institucione shkencore të përbashkëta me persona juridikë e fizikë të huaj krijohen sipas legjislacionit shqiptar.

2. Qendra shkencore dhe teknologjike ndërkombëtare ngrihen me kërkesën e një organizmi ose shoqate ndërkombëtare, me ose pa bashkëpunimin e një institucioni shqiptar, me miratim të Këshillit të Ministrave. Funksionimi i tyre rregullohet me marrëveshje të përbashkët.

Neni 26

Lidhjet ndërkombëtare

1. Institucionet shkencore të përcaktuara në nenin 12 vendosin lidhje e lidhin marrëveshje me institucione shkencore të vendeve të tjera ose ndërkombëtare në kuadrin e marrëveshjeve shtetërore të bashkëpunimit.

2. Këto institucione, brenda kuadrit të detyrave themelore që kanë, vendosin lidhje e marrëveshje të drejtpërdrejta bashkëpunimi me institucione të vendeve të tjera dhe ndërkombëtare.

KREU III ORGANET E DREJTIMIT

Neni 27

Këshilli i Politikës Shkencore dhe i Zhvillimit Teknologjik

1. Pranë Këshillit të Ministrave krijohet Këshilli i Politikës Shkencore dhe i Zhvillimit Teknologjik. Ky Këshill:

a) Përcakton dhe drejton politikën shkencore e teknologjike të përshtatshme për zhvillimin socialekonomik të vendit.

b) Miraton drejtimet dhe përparësitë e politikës shkencore e teknologjike dhe programet kombëtare të kërkimit e zhvillimit.

c) Jep mendim për projektligjet dhe projekvendimet për veprimtarinë shkencore dhe teknologjike, që i paraqiten për miratim Kuvendit Popullor dhe Këshillit të Ministrave.

ç) Bën vlerësimin periodik të arritjeve të politikës shkencore e teknologjike.

d) Cakton detyra për organet shtetërore lidhur me zhvillimin e përdorimin e potencialeve shkencore.

dh) Krijon komisione e grupe pune të përhershme ose të përkohshme për probleme të caktuara.

2. Këshilli i Politikës Shkencore dhe i Zhvillimit Teknologjik përbëhet nga titullarë të ministrave e të institucioneve qendrore dhe shkencëtarë të shquar. Numri i anëtarëve nuk duhet të jetë më i madh se 15.

3. Kryetar i Këshillit është kryetari i Këshillit të Ministrave. Me vendim të kryetarit përcaktohen përbërja e Këshillit të Politikës Shkencore e të Zhvillimit Teknologjik, problematika që do të shqyrtojë dhe rregullorja e funksionimit të tij.

Neni 28

Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë

1. Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë është organ përgjegjës qeveritar për shkencën dhe teknologjinë.

Detyrat dhe kompetencat kryesore të tij janë:

a) Përgatit politikën shkencore e teknologjike dhe programet kombëtare të kërkimit e të zhvillimit që lidhen me të, të cilat ia paraqet Këshillit të Politikës Shkencore dhe të Zhvillimit Teknologjik dhe ndjek zbatimin e tyre.

b) Përgatit dhe u paraqet për miratim organeve kompetente propozime për zhvillimin dhe përmirësimin e sistemit të drejtimit të shkencës e të teknologjisë në aspektet institucionale, financiare e legjislative.

c) Studion dhe përcakton masa, në bashkëpunim me ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, për inkurajimin e zhvillimit dhe transferimin e teknologjisë.

ç) Në bashkëpunim me ministrinë dhe Akademinë e Shkencave, përgatit dhe i propozon Këshillit të Ministrave projektbuxhetin e shtetit për veprimtarinë shkencore dhe teknologjike. Disponon dhe shpërndan fondet për veprimtarinë që mbulon vetë, fondet për projekte me bazë konkurrimi, fondet për veprimtarinë sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit tekniko-shkencor me shtetet dhe organizatat ndërkombëtare që mbulon vetë, si dhe disponon një fond rezervë për veprimtari e projekte të rëndësishme të paparishikuara.

d) Studion, propozon dhe merr masa për zgjerimin e pjesëmarrjes së vendit në bashkëpunimin ndërkombëtar në shkencë e teknologji.

dh) Inkurajon përgatitjen dhe kualifikimin e shkencëtarëve për zhvillimin e veprimtarisë shkencore e teknologjike dhe të ekonomisë e të kulturës, veçanërisht të shkencëtarëve të rinj.

e) Analizon e vlerëson rezultatet e veprimtarisë shkencore e teknologjike dhe rolin e saj në zhvillimin e vendit dhe përgatit raportin përkatës.

ë) Nxjerr rregullore e udhëzime për veprimtarinë shkencore e teknologjike të detyrueshme për organet dhe organizmat shtetërorë.

2. Struktura organizative dhe mënyra e funksionimit të Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë përcaktohen nga kryetari i Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë.

3. Pranë Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë krijohen komisione këshillimore. Përbërja dhe detyrat e tyre miratohen nga kryetari i Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë.

Neni 29

Ministritë dhe institucionet qendrore

Ministritë dhe institucionet qendrore organizojnë dhe drejtojnë veprimtarinë shkencore dhe teknologjike në institucionet shkencore të sistemit të tyre në bazë të këtij ligji dhe të akteve ligjore e nënligjore.

KREU IV

FINANCIMI DHE MJETET KRYESORE

Neni 30

Burimet e financimit

1. Mjete financiare për veprimtarinë shkencore dhe teknologjike të institucioneve shkencore të përcaktuara në nenin 12 krijohen nga:

- a) buxheti i shtetit;
 - b) bashkëpunimi tekniko-shkencor ndërkombëtar;
 - c) kryerja e veprimtarive shkencore e teknologjike (studime, projekte, shërbime etj.) për të tretët, firma e persona juridikë e fizikë shtetërorë e privatë të vendit dhe të huaj;
 - ç) veprimtaria e njësisë prodhuese dhe e bazave eksperimentale të institucioneve;
 - d) fondacione e donatorë të ndryshëm;
 - dh) patentat e shpikjet;
 - e) veprimtari të tjera në mbështetje të veprimtarisë shkencore dhe të zhvillimit teknologjik.
2. Institucionet shkencore janë të detyruara:
- të sigurojnë një përdorim efektiv të fondeve buxhetore;
 - të sigurojnë mundësi aplikimi të rezultateve të veprimtarisë së tyre.

3. Mjetet e vëna në dispozicion të institucioneve shkencore nga organizma joshetërorë ose organizma ndërkombëtarë, përdoren vetëm për përmbushjen e detyrave të caktuara të institucioneve.

Neni 31

Mënyrat e financimit

1. Buxheti i shtetit për veprimtarinë shkencore e teknologjike është zë i buxhetit të shtetit me emërtim të veçantë.

2. Mënyra e hartimit, miratimit, pasqyrimit dhe raportimit të shpenzimeve të buxhetit të shtetit për veprimtarinë shkencore e teknologjike dhe e të ardhurave të institucioneve shkencore përcaktohet me udhëzim të Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë dhe të Ministrisë së Financave.

3. Institucionet shkencore të përcaktuara në nenin 12 raportojnë edhe për përdorimin e të ardhurave nga burime jobuxhetore.

4. Financimi për veprimtarinë shkencore dhe teknologjike nga buxheti i shtetit kryhet si financim institucional dhe si financim problemor.

Neni 32

Favorizime financiare

Shteti favorizon me anë të sistemit të taksave, tatimeve e kreditimeve zhvillimin e veprimtarisë shkencore e teknologjike:

- a) të institucioneve shtetërore për të rritur nivelin e financimit nga burime të tjera, në raport

me financimin nga buxheti i shtetit;

b) të firmave private, të instituteve, të individëve e të grupeve shkencore private, kur ato marrin pjesë drejtpërdrejt në veprimtari shkencore e teknologjike ose financojnë për këtë veprimtari të institucionet shkencore shtetërore.

Masat dhe format e këtij favorizimi përcaktohen me ligj.

Neni 33

Mjetet kryesore

Mjetet kryesore (godina, makineri, pajisje etj.) administrohen sipas dispozitave në fuqi. Ato nuk mund t'i merren institucionit ose të përdoren për qëllime të tjera përveçse me urdhër të Kryetarit të Këshillit të Ministrave ose të ministrit përkatës, pasi të ketë marrë përkatësisht mendimin e ministrit ose të këshillit drejtues të institucionit përkatës.

KREU V

PERSONELI

Neni 34

Përbërja e personelit

Personeli i angazhuar me punë në institucionet e përcaktuara në nenin 12 (pika 2,3 e 4) përbëhet nga:

- personeli shkencor;
- personeli teknik;
- personeli administrativ.

Personeli i shkollave të larta rregullohet me ligjin e arsimit të lartë.

Neni 35

Personeli shkencor

Në personelin shkencor përfshihen punonjës që kanë përgatitje të lartë arsimore dhe profesionale për të punuar për konceptimin, drejtimin dhe kryerjen e veprimtarive shkencore e teknologjike, sipas kërkesave specifike të miratuara nga institucionet shkencore përkatëse.

Neni 36

Personeli teknik

Në personelin teknik përfshihen punonjës me arsim të lartë ose të mesëm, që kanë përgatitjen profesionale të duhur për të kontribuar në veprimtarinë shkencore e teknologjike nën udhëheqjen e personelit shkencor, sipas kërkesave specifike të miratuara nga institucionet shkencore përkatëse.

Neni 37

Personeli administrativ

Në personelin administrativ përfshihen punonjës, si rregull, me arsim të lartë ose të mesëm, të cilët përballojnë detyra të funksionimit e të shërbimit, që mbështetin veprimtari shkencore dhe teknologjike (administratë, financë, ruajtje, mirëmbajtje etj.), sipas kërkesave të miratuara nga institucionet shkencore përkatëse.

Neni 38

Marrja në punë

Marrja në punë e personelit shkencor, teknik e administrativ, si rregull, bëhet me konkurs të shpallur publikisht nga institucionet shkencore përkatëse për vendet disponibël.

Format dhe procedurat e konkurseve e të kontratave përcaktohen në bazë të udhëzimeve të

lëshuara nga Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë.

Neni 39
Emërtimet

1. Punonjësit që përfshihen në personelin shkencor të institucioneve shkencore, emërtohen sipas vendeve të punës në bazë të shkallës së kualifikimit dhe rezultateve të konkursit. Kriteret dhe procedurat për emërtimet sipas kategorive të vendeve të punës përcaktohen në vendime të Këshillit të Ministrave dhe në udhëzime të Komisionit të Kualifikimit Shkencor.

2. Punonjësit që përfshihen në personelin teknik emërtohen sipas kategorive të vendeve të punës.

Kriteret dhe procedurat për emërtimet përcaktohen në rregulloren e institucionit.

3. Personeli administrativ emërtohet sipas emërimit të vendit të punës që ka, në bazë të përcaktimeve që përmban organika e institucionit përkatës.

Neni 40
E drejta e organizimit në shoqata

Personeli i institucioneve të përcaktuara në nenin 12 ka të drejtë të organizohet në shoqata shkencore e teknike vullnetare dhe të bëhet anëtar në shoqata shkencore e teknike ndërkombëtare, ose të vendeve të tjera sipas dispozitave në fuqi.

Neni 41
Liria e personelit shkencor për kërkimin dhe zhvillimin

Personeli shkencor i institucioneve të përcaktuara në nenin 12 është i lirë në zgjedhjen e metodave të kërkimit e të zhvillimit, në qoftë se në dokumentet përkatëse të miratuara, në bazë të të cilave ai punon (programe, projekte, detyra, kontrata etj.), nuk është thënë ndryshe.

Neni 42
E drejta e kualifikimit

Personeli i institucioneve të përcaktuara në nenin 12, në radhë të parë personeli shkencor, ka të drejtë të kualifikohet e të specializohet brenda e jashtë vendit. Institucioni përkatës në bazë të dispozitave ligjore, krijon kushte për këtë (si pjesëmarrje në shpenzimet, ruajtje të vendit të punës, dhënie leje të pagueshme ose jo etj.).

Kujdes i veçantë tregohet për kualifikimin dhe specializimin e punonjësve të rinj.

KREU VI
VLERËSIMI I VEPRIMTARISË SHKENCORE DHE TEKNOLOGJIKE

Neni 43
Vlerësimi i programeve kombëtare

Programet kombëtare të kërkimit dhe të zhvillimit teknologjik janë objekt i vlerësimit në bazë të kriterëve të përcaktuara para zbatimit të tyre.

Bilanci i rezultateve shkencore, teknologjike, ekonomike e shoqërore të programeve bëhet pas përfundimit të tyre. Për ato që vazhdojnë më shumë se një vit, ky kryhet edhe çdo dy vjet pas fillimit të zbatimit.

Neni 44
Vlerësimi i institucioneve shkencore

Veprimtaria e institucioneve shkencore të përcaktuara në nenin 12 është objekt i vlerësimeve periodike nga ministria ose Akademia e Shkencave sipas përkatësisë dhe, sipas nevojës, edhe nga

Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë.

Neni 45
Raportimi

Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë, mbi bazën edhe të raportimeve vjetore të ministrive, të institucioneve qendrore dhe të Akademisë së Shkencave, i paraqet çdo vit Këshillit të Politikës Shkencore e të Zhvillimit Teknologjik një raport për veprimtarinë kërkimore dhe të zhvillimit teknologjik, që pasqyron rezultatet më kryesore të politikës shkencore dhe teknologjike.

Ky raport bën veçanërisht bilancin:

- e zbatimit të programeve kombëtare të kërkimit e të zhvillimit teknologjik;
- e rezultateve të arritura nga bashkëpunimi shkencor e teknologjik me organizatat ndërkombëtare dhe shtetet;
- e zhvillimit të informacionit;
- e gjendjes së personelit të kërkimit;
- e përdorimit të fondeve nga buxheti i shtetit;
- e veprimtarive dhe rezultateve të arritura në bashkëpunim ndërmjet institucioneve shkencore dhe ndërmarrjeve shtetërore e private.

Neni 46
Ekspertiza

1. Ekspertiza e pavarur, si pjesë e pandarë e veprimtarisë shkencore e teknologjike, bëhet në të gjitha nivelet dhe etapat e saj: gjatë caktimit të drejtimeve kryesore të politikës shkencore e teknologjike, gjatë hartimit të programeve kombëtare të kërkimit e zhvillimit teknologjik dhe projekteve që rrjedhin prej tyre, gjatë konkurrimit për të siguruar pjesëmarrje në këto programe e projekte dhe gjatë zbatimit të tyre.

2. Ekspertiza e pavarur kryhet nga shkencëtarë dhe specialistë. Në cilësinë e ekspertëve mund të angazhohen edhe organizma ekspertize e specialistë të huaj. Në ekspertizë nuk mund të angazhohen specialistë që kanë marrë pjesë në formulimin e programit a projektit për të cilin bëhet ekspertiza, ose specialistë që kanë interesa personale në to.

3. Angazhimi i specialistëve dhe organizmave shkencorë në ekspertizë bëhet mbi bazën e kontratës, në të cilën përcaktohen kushtet e kryerjes së ekspertizës. Shpenzimet për bërjen e ekspertizave përfshihen në shpenzimet për financimin e veprimtarisë shkencore e teknologjike.

4. Institucionet shkencore që financohen nga buxheti i shtetit, mund të angazhohen nga organet ligjvënëse dhe qeveritare për ekspertizën e programeve kombëtare të kërkimit e të zhvillimit pa pagesë.

5. Mënyra e kryerjes së ekspertizës dhe përgjegjësia për cilësinë e saj përcaktohen me udhëzime të Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 47
Çmime dhe shpërblime shkencore

Për vlerësimin publik dhe nxitjen e veprimtarive shkencore e teknologjike jepen çmime dhe shpërblime.

Ministritë, Akademia e Shkencave dhe universitetet japin çmime dhe shpërblime shkencore sipas rregullave përkatëse, që miratohen me akte nënligjore.

Neni 48
Fondacione shkencore

Për nxitjen dhe mbështetjen e veprimtarisë shkencore dhe teknologjike krijohet Fondacioni Kombëtar për Shkencën e Teknologjinë me fonde të vëna në dispozicion të tij nga Këshilli i Ministrave dhe të plotësuar nga fonde të organizmave të tjera private e publike të vendit ose të huaja. Ngritja dhe funksionimi i këtij fondacioni dhe i fondacioneve të tjera që mund të krijohen rregullohet sipas dispozitave të Kodit Civil.

Neni 49

Informimi i opinionit publik

Opinionit publik informohet nga institucionet shkencore, nga Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë, nga ministritë dhe nga institucionet qendrore për veprimtarinë shkencore dhe teknologjike të zhvilluar nëpërmjet:

- shpalljes së programeve shkencore kombëtare;
- raportimeve (periodike, vjetore ose të herpashershme) për rezultatet e veprimtarisë kërkimore e zhvillimore dhe për shpenzimet e kryera;
- publikimeve përkatëse.

Neni 50

Botimet

Institucionet shkencore të përcaktuara në nenin 12 botojnë rezultatet e punës kërkimore e zhvillimore në revista shkencore, përmbledhje punimesh, monografi etj.

Shteti kujdeset dhe mbështet veprimtarinë botuese të institucioneve shkencore, duke subvencionuar në rast nevojë botimet më të rëndësishme. Vendimin për subvencionimin e merr ministri ose titullari i institucionit qendror përkatës në bazë të kërkesës së institucionit të interesuar.

Neni 51

Institucione shkencore private

Institucione shkencore private mund të ngrihen duke marrë parasysh parimet e këtij ligji dhe të akteve të tjera ligjore e nënligjore.

Neni 52

Ristrukturimi dhe vlerësimi

Brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Akademia e Shkencave dhe ministritë, në bashkëpunim me Komitetin e Shkencës dhe të Teknologjisë, bëjnë vlerësimin e institucioneve shkencore për të përcaktuar objektivat, detyrat, strukturat e reja dhe përkatësinë e tyre.

Neni 53

Plotësime me akte nënligjore

Brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, hartohen aktet nënligjore dhe udhëzimet që përcaktohen në këtë ligj sipas përkatësisë.

Neni 54

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1001, datë 30.12.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha